



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

VENDIM I DATËS 25.01.2019, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 25.01.2019 ka marr vendim që Kuvendi i Punës i FBK-së të mbahet më 03.03.2019 në Rahovec. Për orën dhe vendin e mbajtjes FBK do të njoftoj opinionin në javën e ardhshme.

Në Kuvendin e Punës, numri një i FBK-së, Arben Fetahu në emër të Bordit të FBK-së do të raportoj para delegatëve të Kuvendit për gjithë atë që është bërë në vitin 2018 dhe për gjithë punën që FBK pret ta bëjë në vitin 2019.

Muaji shkurt për FBK-në është mjaft i ngjeshur duke pas parasysh faktin se të planifikuara janë 5 aktivitete:

1. Më 24 shkurt në Prishtinë, ndeshja Kosovë – Rumani në kuadër të parakualifikimeve për Eurobasket 2021;
2. Prej 27 shkurt deri më 3 mars në Rahovec do të organizohet Final 8 i Kupës së Kosovës;
3. Prej 27 shkurt deri më 3 mars do të mbahet FIBA SCOD Camp për gjyqtarë në Gjakovë dhe Rahovec;
4. Prej 27 shkurt deri më 3 mars do të mbahet FIBA Kampi për Gjyqtarët Potencial për Thirrje të FIBA-s në Gjakovë dhe Rahovec;
5. Më 3 mars do të organizohet Kuvendi i Punës së FBK-së në Rahovec.

Sinqerisht,
Arben Fetahu
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: federata@basketbolli.com, mob: +386 49 738 080

